

Termet e Referencës

Ekspert/e për zhvillimin e politikës për Anti-Korrupsion

HYRJE

HANDIKOS, "Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës" është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin "Handikos for Child Rights-H4CR", i cili financohet nga Agjencia Suedze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për zhvillimin e politikës Anti-Korrupsion. Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për zhvillimin e politikës duke ofruar ekspertizë në hartimin e procedurave që synojnë parandalimin e korruptionit duke siguruar respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave ligjore.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Diplomë universitare në juridik ose shkenca sociale;
- Përvjë të gjerë në hartimin dhe realizimin e detyrave të ngjashme (preferohet në sektorin e OJQ-ve);
- Aftësi për të prodhuar politika dhe procedura të shkruara mirë, në format të lehtë për lexuesin, duke dëshmuar shkathësi të shkëlqyeshme analitike dhe të komunikimit;
- Njohuri të standardeve, ligjeve dhe rregulloreve ndërkombëtare kundër korruptionit.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Zhvillimi i politikës Anti Korruption, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Kryerjen e një vlerësimi të plotë të strukturës dhe praktikave aktuale të qeverisjes brenda organizatës;
- Zhvillimin e një kuadri rregullativ të përshtatur kundër korruptionit që përputhet me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare;
- Krijimin e mekanizmave për raportimin dhe hetimin e rasteve të dyshuara të korruptionit, duke përfshirë një sistem raportimi konfidencial;
- Zhvillimin e politikës kundër korruptionit (duke përfshirë luftimin e mashtrimit dhe ryshfetit) bazuar në praktikat më të mira të identifikuara, të përshtatura me kontekstin dhe misionin e HANDIKOS.

V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS.

Ai/ajo do të angazhohet për 4 ditë në periudhën kohore prej një muaj dhe pritet të dorëzojë: Një dokument që mbalon përgjegjësitë e përmendura në seksionin "Detyrat dhe Përgjegjësitë".

| Detyra | Kohëzgjatja |
|---|-------------|
| Angazhimi i ekspertit/es për zhvillimin e politikës anti-korruption | 4 ditë |

VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo, pas finalizimit të dokumentit/raportit.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit finanziar.

VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metolodologji e punës për këtë angazhim ose shembuj të angazhimeve të mëparshme të natyrës së ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi finanziar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: **Ekspert për zhvillimin e “Politikës Anti-Korrupsion”.**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 26/05/2024, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime.**